POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 U filmuan duke marrë para nga një shofer, AMP arreston 2 efektivë policie të Komisariatit nr.3 në Tiranë
2 VIDEO nga sulmi me thikë i 18-vjeçarit ndaj 32-vjeçarit në Shkodër
3 Kush ia bleu 15 mln euro Agron Shehajt vilën që vetëm 4 vite më herët kishte paguar 2.9 mln €?! Deputeti zero transparancë! Paralajmërohet padi në SPAK, Balla: Pastrim parash
4 'Faji i Tuchel' dhe 'Arrogancë argjentinase', shtypi anglez e ka me trajnerin gjerman të kombëtares
5 Argjentina rrezikon gjobë nga FIFA për banderolën 'Las Malvinas', historia e luftës me Mbretërinë e Bashkuar! U vranë 910 ushtarë

Kronikë

# Do i shiste 4 pistoleta grupit kriminal në Sarandë, arrestohet i riu! Momenti kur policia e ndjek nga pas dhe e rrethon në tunelin e Skërficës (VIDEO)

*Gjatë kontrollit të një automjeti janë gjetur dhe sekuestruar 4 pistoleta të tipit "Glock", të cilat do t'i shiste në qytetin e Sarandës një grupi kriminal.*

"Mos lëviz, policia!" Arrestohet 31-vjeçari në Skërficë, sekuestrohen 4
Report TV
Watch on

Redaksia
16 Korrik, 10:04 | **Përditesimi: 16 Korrik, 12:21**

Një aksion kundër trafikut të armëve nga policia e Sarandës ka çuar në arrestimin e një 31-vjeçari nga Tirana. Kejdi Banaj u kap nga blutë në tunelin e Skërficës teksa udhëtonte me automjetin e tij.

Gjatë kontrolleve të kryera u gjetën 4 pistoleta të tipit "Glock", të cilat dyshohet se do t'ia shiste një grupi kriminal në Sarandë.

Para ndalimit të tij, i riu ishte mbajtur në vëzhgim nga shërbimet e policisë.


LEXO EDHE:
**Ndotje mjedisore në Dhërmi nga përpunimi i inerteve të gurit, IKMT pezullon dhe gjobit 5 kompani (FOTO)**

Siç shihet edhe nga pamjet lëvizjet e të riut janë monitoruar me dron deri në momentin e hyrjes së tij në tunelin e Skërficës. Pas hyrjes 31-vjeçari rrethohet nga blutë ndërsa këta të fundit dëgjohen të thonë 'Ndal, mos lëviz policia'.

> *"Shërbimet e Komisariatit të Policisë Sarandë, si rezultat i një hetimi me metoda speciale, kryer në drejtimin e Prokurorisë, me qëllim identifikimin dhe ndalimin e shtetasve, të cilët individualisht ose në grup, përbëjnë rrezik për kryerje të ngjarjeve kriminale dhe për sigurinë e qytetarëve, finalizuan në bashkëpunim me shërbimet e Njësisë së Sigurisë Publike, Njësia Fier, dhe me shërbimet e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale të DPPSh-së, operacionin e koduar "Mekanizmi".*
>
> *Si rezultat i operacionit u arrestua në flagrancë shtetasi K. B., 31 vjeç, banues në Tiranë.*
>
> *Shërbimet e Policisë kanë mbajtur në vëzhgim automjetin që drejtonte 31-vjeçari dhe në tunelin e Skërficës kanë kryer ndalimin e tij.*
>
> *Nga kontrollet në automjet u gjetën të fshehura në dysheme, 4 armë zjarri (pistoleta) që dyshohet se janë trafikuar në Shqipëri, në pjesë, dhe janë montuar më pas, me qëllim shitjen një grupi kriminal në Sarandë.*
>
> *Hetimi vijon me qëllim identifikimin dhe nxjerrjen përpara përgjegjësisë penale, të shtetasve të tjerë të përfshirë në këtë rast", njoftoi sot policia*

*Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme*

-----------------------------

**Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë**

Xh.K/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Vlore | Kejdi Banaj | arme zjarri | tuneli i skerfices | sarande

Komento

## Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 14 Korrik, 12:01
Si e vlerësoni vendimin e PD për të bojkotuar seancat plenare?
Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera
Iu gjendën në banesë 4 armë zjarri dhe municion, arrestohet 21-vjeçari në Shkodër (VIDEO) 16 Korrik, 08:53
I paraburgosuri ndërron jetë në spitalin e Vlorës, 50-vjeçari pësoi arrest kardiak 15 Korrik, 22:22
Vlorë/ Automjeti i policisë përplas me vijat e bardha 13-vjeçarin, i mituri jashtë rreziku për jetën 15 Korrik, 20:56
Dhunuan 70-vjeçarin në banesën e tij dhe e kërcënuan me pistoletë çakmak për ta grabitur, arrestohen tre të rinjtë në Himarë (EMRAT+ VIDEO) 15 Korrik, 12:54
Gjuetia spektakolare, peshkatari në Vlorë fiton 'përleshjen' nën ujë, kap peshkun 27 kilogramësh (VIDEO) 15 Korrik, 12:17
Riaktivizohet vatra e zjarrit në Novoselë, tymi mbulon zonën (VIDEO) 15 Korrik, 08:59
Vlorë/ E përplasi makina, humb jetën 80-vjeçarja në Vranisht 14 Korrik, 22:45
Iu afruan pushuesve, gjobiten me 500 000 lekë dy drejtuesit e gomoneve në Vlorë! Bllokohen edhe mjetet lundruese (VIDEO) 14 Korrik, 16:29
Zjarr në Novoselë, digjen shkurre e barishte, rrezikohen banesat (VIDEO) 14 Korrik, 15:17
Përplasja në Zvërnec, Apeli lë në burg pronarin e kompanisë 'Major Security' dhe rojen private! Njëri në arrest shtëpie — Keti Banushi 14 Korrik, 14:32
Fluks në Pediatrinë e Vlorës: 90 fëmijë kërkojnë ndihmë në 24 orë! Mjekja: Mos i ekspozoni në diell — Armand Xhelili 14 Korrik, 13:50
Zjarr në lagjen '15 Tetori' në Vlorë, flakët përfshijnë një hapësirë me pisha e shkurre (VIDEO) 15 Korrik, 09:22

Lajmi i fundit
'Shkenca politike, por vendin ma zunë Zegjinetë', - Me pankarta dhe kapele, studentët 'diplomohen' në sheshin e protestës (VIDEOLAJM) 16 Korrik, 20:52



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit
‘Shkenca politike, por vendin ma zunë Zegjinetë’, - Me pankarta dhe kapele, studentët ‘diplomohen’ në sheshin e protestës (VIDEOLAJM)
16 Korrik, 20:52
RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com